

Elona Kuçi, lindur në Tiranë, në 20 Gusht të vitit 1988, ka kryer studimet e larta për “Manaxhim”, pranë Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës.

Ajo, ka një eksperiencë të gjatë në fushën e ekonomisë dhe burimeve njerëzore.

Nga viti 2011 deri në qershor të vitit 2015 ka qënë pjesë e sektorit privat ku ndër të tjera, i është besuar edhe drejtimi i departamentit të financës dhe burimeve njerëzore.

Më pas ajo është bërë pjesë e administratës publike duke ushtruar funksionin e specialistit të financës pranë Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit. Ndërsa në vitin 2016, është emëruar përgjegjëse e sektorit të finances pranë këtij institucioni.

Aktualisht, që nga maji i vitit 2022, ajo drejton Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Përpos eksperiencës së gjatë, njohuritë e saj në fushën e ekonomisë dhe burimeve njerëzore, janë thelluar edhe përmes trajnimeve të vazhdueshme, që ajo ka ndjekur, brenda dhe jashtë vendit.